



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës Gazeta Zyrtare nr 28/2008 dhe nenit 51 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/ 491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

## V E N D I M

### PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ 2.000,00€ KLUBIT TË FUTBOLLIT "VITIA" NGA VITIA

#### I.

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Vitisë i NDAN mjete financiare në shumë prej 2.000,00 euro me shkronja (dymijë euro) Klubit të Futbollit "Vitia" nga Vitia në emër të mbështetjes financiare të këtij klubi të futbollit për zhvillimin e garave në Ligën e parë të Republikës së Kosovës.

#### II.

Mjetet nga neni 1 i këtij Vendimi, sigurohen nga Buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2016 nga kodi buxhetor për subvencione i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Komunës së Vitisë.

Obligohet drejtori i KF "Vitia" nga Vitia që të paraqet raport me shkrim për mjetet e shpenzuara nga neni 1 i këtij vendimi te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të KF "Vitia" nga Vitia.

#### III.

Për zbatimin e këtij Vendimi, do të kujdeset Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Zyra e Thesarit e Komunës së Vitisë

#### IV.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kryetarit të Komunës së Vitisë.

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

Viti, 13.05.2016

Vendimi u dorëzohet:

1. KF "Vitia" Viti
2. Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport
3. Zyrës së thesarit dhe
4. Arkivi

